


MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

MIDIS



BSPSH

**Bashkimi i Sindikatave të
Pavarura të Shqipërisë**



BSPK

**Bashkimi i Sindikatave të
Pavarura Kosovë**

E lidhur sot me datë 13.1.2014 në Selinë e Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë .

Kjo marrëveshje bazohet në bashkëpunimin e vazhdueshëm midis dy konfederatave, bashkëpunim, i cili ka filluar që në nëntor të vitit 2006 dhe është shtrirë deri në federatat e profesioneve dhe në rrafshin horizontal midis rajoneve.

Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje të dy konfederata paraqesin vizionin e tyre për vazhdimin e këtij bashkëpunimi jo vetëm në fushat ku ai funksionon por edhe në fusha të tjera si edukimi sindikalist, projekte të përbashkëta që i shërbejnë forcimit të strukturave tona sindikaliste, funksionimit më të mirë të sindikatave tona, forcimit të jetës së brendshme të sindikatave, dialogut social në nivele të larta për t'iu përgjigjur sfidave me të cilat i duhet të ndeshen sindikatat tona.

Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje do të arrihen raporte reciproke dhe bashkëpunim e solidaritet sindikalist midis dy konfederatave që në hartimin e strategjive dhe politikave sindikaliste e sociale dhe në zbatimin e fushatave dhe aksioneve të përbashkëta në mbrojtje të interesave të anëtarëve të sindikatave tona.

Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje do të mirorganizohet shkëmbimi i përvojave pozitive dhe standardeve në fushën e marrëdhënieve të punës.

Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje do të realizojmë programe studimore për institucionalizimin e mëtejshëm të sindikatave tona dhe krijimin e marrëdhënieve institucionale edhe me shoqërinë civile duke realizuar lobime të favorshme ndaj situatave që mund të na paraqiten.

Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje do të hartohen nga stafet studimore dhe administrative të dy konfederatave tona programe studimore e statistikore për

zbatimin e politikave sindikale në drejtim të tregut të punës, kërkesave të tij, uljes së varfërisë, luftën kundër punës informale dhe reformat në fushën e pensioneve.

Nëpërmjet kësaj marrëveshje do t'i krijohen mundësi më të mëdha bashkëpunimit të rrjeteve tona të rinisë si e ardhmja e dy konfederatave tona duke organizuar veprimtari të përbashkëta edukimi dhe seminare e trajnime, ku të shkëmbehet përvoja pozitive për të afruar sa më shumë të rinj e të reja në rrjetet tona të rinisë për të garantuar një të ardhme të sigurtë të sindikalizmit në të dy vendet tona.

Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje do të bëjmë të mundur funksionimin e rrjeteve të grave duke rritur përfaqësueshmërinë e tyre dhe duke punuar sistematikisht në veprimtari të përbashkëta edukative të realizojmë një forum grashë që të trajtojë problem të diskriminimit në vendin e punës, në pagë etj duke bërë të mundur realizimin e një barazie gjinore në vendin e punës.

Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje do të realizohet edukimi sindikalist dhe realizimi i projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare, që do të sjellë një shkëmbim përvojash.eksperiencash, njohurishë që do t'i shërbejnë sindikatave tona, kjo do të realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së përbashkët në projektet tona.

Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje nga liderët e dy konfederatave shpreh vullnetin e të gjitha strukturave dhe organeve drejtuese të dy konfederatave tona për arritje dhe suksese në zhvillimet sindikaliste në të dy vendet tona.

Për BSPSH

PRESIDENTI

Gëzim Kalaja

Për BSPK

PRESIDENTI

Haxhi Arifi